



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 340, Datë 21.12.2022

MBI

RINOVIMIN E LICENCËS NR. 395 SERIA F18 TË SHOQËRISË “ENERGJI
ASHTA” SH.P.K., NË VEPRIMTARINË E FURNIZIMIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16 dhe nenit 37 pika 2, gërma “a”, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; si dhe neneve 4, pika 1, gërma “a”, 5 pika 1, gërma “a” dhe nenit 16 të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016; si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE, në mbledhjen e tij të datës 21.12.2022, mbasi shqyrtoi relacionin e përpiluar nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes “Mbi rinovimin e licencës së shoqërisë “ENERGJI ASHTA” sh.p.k. në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike”,

Konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 314, datë 06.12.2022 vendosi të fillojë procedurën për rinovimin e licencës së shoqërisë “ENERGJI ASHTA” sh.p.k., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.
- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 07.12.2022 dhe 08.12.2022) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 16.12.2022), nuk rezultoi të ketë të tilla.
- Në zbatim të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” e ndryshuar, aplikuesi për rinovimin e licencës në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike duhet të depozitojë në ERE: dokumentacionin e kërkuar nga neni 16 “Rinovimi i licencës”; formatin e plotësuar të aplikimit, sipas Shtojcës 1 (neni 16, gërma “a”); çdo modifikim ose ndryshim të mundshëm të dokumentacionit të dhënave teknike apo dokumentacionit tjetër të depozituar në aplikimin për pajisje me licencë (neni 16, gërma “b”); informacion mbi ushtrimin e veprimtarisë e licencuar (kontrata për shitblerjen e energjisë, nëse ka pasur) (neni 16, gërma “c”) Shtojca 1.I; Të ketë kryer pagesën e aplikimit dhe atë të rregullimit në ERE (neni 16, pika 7).

- Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit për t'u pajisur me licencë nga ERE, në zbatim të Aneksit A të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, e ndryshuar. Po ashtu shoqëria nuk rezulton debitore e pagesave të rregullimit ndaj ERE-s.
- Duke qene se Licenca nr. 395 Seria F18, e shoqërisë “ENERGJI ASHTA” sh.p.k, në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, përfundon afatin e saj në datën 30.01.2023, vlerësohet që afati i rinovimit të saj të fillojë nga data 31.01.2023.
- Nga aplikimi i paraqitur nga shoqëria “ENERGJI ASHTA” sh.p.k. rezulton se dokumentacioni është i plotësuar tërësisht si vijon:
 - Neni 16, pika 1, gërma “a”, “b”, “c”. **Plotësuar.**
 - Neni 16, pika 7. **Plotësuar.**

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të rinovojë licencën nr. 395 Seria F18 të shoqërisë “ENERGJI ASHTA” sh.p.k., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 26, datë 30.01.2018, për një afat 5 (pesë) vjeçar duke filluar nga data 31.01.2023.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë palët e interesit për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit AHMETI